

PRANVERA DIBRA TELI**SHËRBIMI I JASHTËM I SHTETIT SHQIPTAR
GJATË VITEVE TË MONARKISË
(1928-1939)**

Pas vendosjes së Monarkisë, 1 shtator 1928, dhe në rrethanat e ekzistencës të një stabiliteti politik në vend, procesi për ngritjen dhe konsolidimin e institucioneve shtetërore dhe formësimin e kuadrit ligjor brenda të cilit do të vepronin këto institucione, njih zhvillime mjaft dinamike dhe domethënëse. Legjislacioni i periudhës së Monarkisë shënon një hap përpara, duke plotësuar atë të periudhës republikane. Legjislacioni i ri e vendos jetën e shoqërisë dhe veprimtarinë e shtetit mbi një bazë ligjore kushtetuese.¹

Ndërtimi i një shërbimi diplomatik profesional e përfaqësues të shtetit shqiptar, jo vetëm si simbol i ekzistencës së pavarur të një shteti, por edhe si pasaportë e komunikimit të tij me jashtë, përbënte prioritet gjatë kësaj periudhe. Krahas zhvillimit të sistemit juridik dhe strukturave të larta shtetërore që drejtonin shërbimin diplomatik e konsullor, etapë pas etape filluan të ngrihen edhe strukturat e institucionet që realizonin shërbimin diplomatik e konsullor shqiptar.² Filluan të aplikohen praktikat dhe të grumbullohen përvojat, të përgatiten kuadrot e të zhvillohet veprimtaria diplomatike dhe konsullore, të zgjerohen lidhjet dhe marrëdhëniet me vendet e popujt e tjerë. Nga ana tjetër ky proces do të përballonte edhe sfidat që do të shoqëronin atë gjatë krejt përpjekjeve për ndërtimin e mbushjen e skeletit organizativ të këtij shërbimi në gjysmën e dytë të viteve '20 dhe në vitet '30, vite të trazuara në Shqipëri e jashtë saj. Në sfidat kryesore që duheshin përballuar do të veçonim:

a - Të qenurit midis modeleve të një të shkuare lindore dhe aspirimit për arritjen e disa standardeve perëndimore, krijonte shpesh konfuzion në etapat e konsolidimit të këtij shërbimi. Shumica e diplomatëve janë të

¹ Arben Puto, *Shqipëria politike, 1912-1939*, Tiranë: "Toena", 2009, f. 469.

² Thimi Çollaku, *Shërbimi konsullor në trojet shqiptare*, Tiranë: "ADS", 2012, f. 158.

arsimuar në shkollat më të mira të Perandorisë Osmane, një pjesë e tyre kanë edhe eksperiencë si diplomatë në shërbim të Perandorisë Osmane para vitit 1912, ndërkohë që përpiqen të ndërtojnë një shërbim të jashtëm me fytyrë perëndimore, duke qenë në anën e duhur të historisë.

b - Mungesa e një trashëgimie në funksion të këtij shërbimi në Shqipëri, që të shërbente si bazë mbi të cilën të ndërtohej e të zhvillohej diçka e re.

c - Mungesa e personelit të kualifikuar që t'i përgjigjej standardeve që kërkonte hierarkia e një shërbimi diplomatik funksional.

d - Kriza ekonomike e viteve '30, e cila "bllokonte frymëmarrjen" e këtij shërbimi të kushtueshëm, për të punuar në efikasitetin e tij të plotë.

e - Ndërtimi centralizues institucional i vetë monarkisë. Prezenca e disa organeve qendrore mbi dikasteret. Kështu, çdo propozim profesional që vinte nga institucioni i Ministrisë së Punëve të Jashtme (MPJ), qoftë për një funksionim më të mirë të strukturave të shërbimit apo emërimet e rangjeve të ulta diplomatike ose staf teknik, duhej të merrte mendimin e Këshillit të Shtetit, i cili për rrethana të caktuara e mbante ose e rrëzonte propozimin e MPJ-së.

f - Situata e vështirë politike në të cilën vepronte shërbimi diplomatik e konsullor në periudhën në fjalë, në kushtet e presionit diplomatik italian mbi politikën e jashtme shqiptare, apo problematika e rënduar me fqinjët.

Drejt një shërbimi të jashtëm të organizuar e profesional

Shpallja e Monarkisë në Shqipëri e gjeti MPJ pa as edhe një rregullore të brendshme që të organizonte punën e të menaxhonte drejtimin e shërbimit të jashtëm të ngritur gjatë gjysmës së parë të viteve '20.³ Ky fakt e bënte shumë urgjente nevojën e ndërtimit të një shërbimi të jashtëm të organizuar e profesional, prezantues i denjë i një monarkie.

Në vitin 1928, shteti shqiptar përfaqësohej jashtë me:

8 Legata: Washington, Londër, Paris, Romë, Athinë, Beograd, Sofie, Angora.

4 Konsullata të Përgjithshme: Bari, Janinë, Aleksandri, Bukuresht.

6 Konsullata: Boston, Vjenë, Korfuz, Selanik, Stamboll, Konstancë.

³ Arkivi i Ministrisë së Punëve të Jashtme (më tej: AMPJ), Viti (më tej: V.), 1928, Dosja (më tej: D.) 24, fl.5, Korrespondencë e MPJ me Ministrinë e Drejtësisë, 28 gusht 1928.

Përfaqësi Konsullore Nderi: Kryekonsullata Paris, Stokholm, Luksemburg, Milano, Romë, Bukuresht e Gjenevë, Konsullata: Konstancë, Pragë, Mynih e Lejpcig, si dhe një nënkonsullatë në Brindisi.

Në mungesë të një kuadri ligjor të miratuar për rregullimin e organizimit të shërbimit të jashtëm, në fillimin e jetës së Monarkisë Shqiptare në vitin 1928, mangësitë e ndeshura korrigjoheshin një e nga një e rast pas rasti, duke ndërtuar në fakt bazat e para ligjore rregulluese.

Vëmendja kryesore iu kushtua përcaktimeve të pozicioneve të nevojshme të punës në përfaqësi e në ministri, duke iu përgjigjur nevojave të politikës së jashtme shqiptare për kohën. Në mungesë të një organike të miratuar, hapja e pozicioneve të reja të punës në përfaqësi bëhej me propozim të MPJ, miratim të qeverisë dhe dekretim të Mbretit. Në këtë dekretligj bëhej kujdes që të parashikohej çdo gjë në detaje, për të mos i lënë vend interpretimeve nga të dy palët, shteti dhe i punësuarit. Në të përcaktohej lloji i pozicionit që do të hapej, rroga e alokacioni, burimi financiar ku do të sigurohej kjo shtesë në buxhetin financiar të shërbimit të jashtëm.⁴ Ky dekretligj u botua në “Fletoren Zyrtare” të Mbretërisë, e cila dilte një herë në javë dhe botohej nga Ministria e Punëve të Brendshme.

Një anomali e shërbimit të jashtëm në vitet '20, shprehje edhe e pastabilitetit politik brenda vendit dhe moseksperiencës diplomatike, ishin lëvizjet e shpeshta të nëpunësve diplomatë nga qendra nëpër përfaqësi e anasjelltas. Për të rregulluar këtë anomali të shoqëruar me kosto financiare, me anë të një qarkoreje drejtuar Ministrisë së Punëve të Jashtme, Kryesia e Këshillit të Ministrave, kritikon rëndë transferimet e shpeshta të nëpunësve gjë e cila dëmtonte, sipas qarkores, vetë integritetin profesional të nëpunësve, por edhe arkën e shtetit duke e ngarkuar me shpenzime udhëtimi e dieta jashtë fuqisë e gjendjes së vet. Kërkohej kufizimi i transferimeve të nëpunësve, dhe nga ana tjetër këto transferime të mos provokoheshin pa patur arsye justifikative ose dëshirën e të dy palëve që të transferohen. Kriteret e kërkuara demonstroi një praktikë tepër serioze e të argumentuar të lëvizjes. Çdo kërkesë për transferim do të përmbante arsyet e qarta për kryerjen e transferimit të diplomatit; ndëshkim disiplinor, gradim apo dëshirë. Kërkesat për emërim apo gradim do të shoqëroheshin nga një jetëshkrim i personit që do të përmbante shkurtimisht jetëshkrimin e nëpunësit: shkollën që ka kryer,

⁴ *Po aty*, fl.14, Fletorja Zyrtare, nr.106, dt. 9.11.1928.

nëpunësitë e mëparshme, datën e arsytimit të largimit nga shërbimi, aftësinë e provuar të tij.⁵

Për të nxitur e forcuar ndjenjën e përgjegjësisë së diplomatëve në kryerjen e detyrës së ngarkuar, për t'i dhënë peshën që i takonte postit të diplomatit si përfaqësues i interesave të Atdheut dhe në shërbim të tyre, Këshilli i Ministrave (KM) me propozim të MPJ në mbledhjen e 6 tetorit 1928, miratoi *Formulën e Betimit* për nëpunësit diplomatë që shërbenin jashtë vendit. Çdo nëpunës që emërohej në përfaqësi do të shqiptonte qartë *Formulën e Betimit* para drejtuesit të përfaqësisë dhe më pas do të vendoste datën dhe nënshkrimin e të betuarit. Ky dokument i nënshkruar nga diplomati i emëruar duhej të dërgohej në MPJ.⁶ Ndërsa drejtuesit e përfaqësive kur emëroheshin vetëm do të nënshkruanin *Formulën e Betimit*, pa e shqiptuar atë. Teksti i *Formulës së Betimit*, parashikonte marrjen e përgjegjësisë nga diplomati i emëruar. Ai vijonte “Betoheh para Perëndisë e me nderin tim’ dhe të nëpunësit për besnikëri ndaj mbretit të shqiptarëve, Zogu i I-rë, e për shërbim ndaj Atdheut, ligjeve në fuqi, për besnikëri, ndërgjegje e discipline”.⁷

Në një qarkore të dt.17 tetor 1928 të miratuar nga KM me propozimin e MPJ për përfaqësitë, mbi performancën e trupit diplomatik e konsullor shqiptar jashtë vendit, të bie në sy theksi që i vihet dy aspekteve kyçe. Nga diplomatët, si prezantuesit e seriozitetit të shtetit jashtë kufijve të tij, kërkohet performancë personale, përveç profesionalizmit, në kryerjen e detyrave të tyre zyrtare. Në të thuhej: “Intervenimi juaj pranë autoriteteve të vendit do të bëhet me një gjuhë të ëmbël e moderne, qi kështu të fitoni një konsideratë personale pranë atyre autoriteteve, e cila gja mund të lehtësojë shumë veprimin tuaj.”⁸ Në lidhje me punën me shqiptarët që jetonin në vendet ku përfaqësitë ishin të akredituara, një ndër detyrat kryesore të shërbimit konsullor, në qarkore theksohej: “Zotnia e juaj keni për detyrë të mbronit interesat e nënshtetasve tonë pranë autoriteteve t’atjeshme, por në këtë pikë, duhet të keni gjithmonë parasysh se Zotnia e Juaj nuk jeni agjentë tregëtie. Kur nënshtetasit tanë paraqesin ndonjë çështje, e cila mund të jetë në kundërshtim me ligjet e rregulloret tona ose me ato të atij vendi, jeni të

⁵ *Po aty*, V. 1928, D. 4, fl.30, Qarkore e KM për MPJ, 25.9.1928.

⁶ *Po aty*, V. 1928, D. 8, fl.3, Qarkore e MPJ, 16.10.1928.

⁷ *Po aty*, fl. 4.

⁸ *Po aty*, V. 1928, D. 25, fl. 90, Qarkore e MPJ, 17.10.1928.

lutun mos me e marrë parasysh. Sa më i madh është autoriteti që u asht besu, aq më shumë urtësi dhe moderacion do të përdorni në ushtrimin e atij autoriteti”.⁹

Komponent tjetër që i mungonte administratës shqiptare, dhe më e nevojshme kjo në procesin e ndërtimit të strukturave të shërbimit të jashtëm, ishte kultura administrative e treguar nga nëpunësi diplomat si përfaqësues i shtetit në shërbim të tij dhe të shtetasve të vet. E ndërgjegjshme për këtë situatë, MPJ tërhoq vëmendjen e strukturave të shërbimit të jashtëm, më 4 nëntor 1928 për korrektesë në qëndrimin zyrtar ndaj kërkesave të shtetasve shqiptarë brenda e jashtë vendit si dhe shtetasve të huaj: “..Është detyrë e çdo zyre dhe autoriteti drejtues të lajmërojë për rezultatin e kërkesës që ka bërë nënshtetasi shqiptar apo i huaj, i cili i është drejtuar me një lutje autoritetit për mbarimin e një pune, cilido qoftë përfundimi pozitiv apo negativ, në favor apo disfavor të të interesimit, i cili shumë herë mund të mos ketë edhe të drejtë për kërkesën që bën”. Përgjigjja kërkohej të ishte e drejtpërdrejtë ndaj të interesuarit me një akt zyrtar të nënshkruar prej ministrit ose shefit të misionit diplomatik, ose në emër të Sekretarit të Përgjithshëm të MPJ, kjo në varësi të çështjes dhe problemit.¹⁰ Në gusht 1929, KM urdhëronte që nëpunësi që nuk u kthente përgjigje kërkesave personale dhe shtetërore, duke u bërë shkak që me indiferencën e tij të bëhej shkak për dëmtimin e interesave personale ose shtetërore, do të dorëzohej në gjykatë për tu dënuar sipas dispozitave të Kodit Penal.¹¹

Rëndësi e veçantë i jepej përdorimit të gjuhës shqipe në praktikën e komunikimit zyrtar si element shumë i rëndësishëm i dinjitetit të një shteti sovran e të pavarur. Në gusht 1929, MPJ vë në dijeni të gjitha strukturat e saj mbi konstatimin e bërë mbi përdorimin e gjuhës së huaj në praktikën zyrtare. Në qarkoren e dërguar thuhej: “Mbasi shteti si gjuhë zyrtare ka gjuhën shqipe, një veprim i këtillë jo vetëm që lëndon sentimentin kombëtar dhe tregon pakujdesin e nëpunësve kompetentë, por është edhe antikonstitucional se kundërshton dispozitat e Statutit Themeltar. Lutemi prandaj urdhëroni ndalimin e këtij veprimi dhe dispononi ndëshkimin e nëpunësve që kanë guxuar të bëjnë një vepër të

⁹ *Po aty*, fl. 91.

¹⁰ *Po aty*, fl. 94, Qarkore e MPJ, 4.11.1928.

¹¹ *Po aty*, V. 1929, D. 89, fl.13, Qarkore e KM për MPJ, 23.8.1929.

tillë”.¹² Rëndësi e madhe i vihet përdorimit në korrespondencë të emrave shqip të qyteteve të Mbretërisë, si, bie fjala Durrës e jo Durazzo, Vlorë e jo Valona, Shkodër e jo Scutari.¹³

Me qëllim shmangien e abuzimit me praktikat dokumentare në favor të një pale të interesuar, KM mbi bazën e kontrollit të ushtruar nga Inspektoria e Përgjithshme, urdhëron dikasteret, dhe më pas MPJ përfaqësitë, që konceptet origjinale të zhdukeshin pasi të kishte dalë kopja e shtypur në makinë dhe e firmosur nga nëpunësi përgjegjës, me një nënshkrim të lexueshëm. Kjo masë u detyrua të theksohej për shkak të faktit që në konceptin me dorëshkrim shtoheshin rreshta me dorë, ndërsa po të shtoheshin tek kopja e shtypur, vihej re ndryshimi. Përveç kësaj mbajtja e dorëshkrimeve shtonte shumë volumin shkresor, sa vështirësonte sistemimin e tyre në arkiva. Në qoftë se do të gjendeshin në rast inspektimi nga Inspektoria e Përgjithshme e Mbretërisë Shqiptare, koncepte të shkruara, apo të shtypura, por të panënshkruara, do të zbatoheshin dispozitat e Kodit Penal për neglizhencë e keqpërdorim të detyrës. Për shtesë në koncept kishte të drejtë vetëm shefi i zyrës, i cili firmoste në përgjegjësinë e tij në krah të kësaj shtese. Përveç kësaj urdhërohej që në çdo dokument, në mbyllje të praktikës të shënoheshin në anë veprimet që janë bërë për të, ose nëse nuk janë bërë, arsyen pse nuk janë kryer veprimet. Kjo duhej të firmosej qartë nga nëpunësi që kishte kryer veprimin. Pas kësaj akti mund të dorëzohej në arkiv.¹⁴

II. Ligji Organik

Koha nxirrte të domosdoshme ekzistencën e një ligji afatgjat e të qëndrueshëm ndaj sfidave që po ndesheshin shërbimi i jashtëm shqiptar, si shërbimi më i kualifikuar i shtetit, duke siguruar një bazë të fortë për hedhjen e themeleve solide për një shërbim të jashtëm profesional e motivues. Në kuadrin e ngritjes së kuadrit ligjor të shtetit shqiptar, Mbreti Zog kishte urdhëruar që të gjitha dikasteret të ngrinin komisione të posaçme për të ndërtuar Ligjin Organik të tyre, i cili bashkë me buxhetin

¹² *Po aty*, fl.15, Qarkore e KM për MPJ, 28.8.1929.

¹³ *Po aty*, V. 1930, D. 18, fl. 53, Qarkore e MPJ, 25.8.1930.

¹⁴ *Po aty*, V. 1928, D. 25, fl. 96, Korrespondencë e Inspektorisë së Përgjithshme me Mbretin 27.10.1928; *po aty*, fl.105, Qarkore e MPJ, 20.11.1928.

financiar do të miratohej nga KM deri me 1 janar 1929 dhe do të kalonte më pas për aprovim në Parlament.¹⁵

Komisioni i Posaçëm i ngritur në MPJ, i drejtuar nga ministri i Punëve të Jashtme, në fillim Iliaz Vrioni e më pas Rauf Fico punoi mbi projektin që kishte nisur të hartohej që gjatë periudhës së Republikës Shqiptare duke e pasuruar me elementët që i shkonin një regjimi monarkik. Ministria e Punëve të Jashtme e dërgoi këtë projektligj në KM me 15 dhjetor 1928.¹⁶ Më pas projektligji do të kalonte në Dhomën Legjislative.

Pasi u miratua në Parlament, Ligji Organik hyri në fuqi me Dekret Mbretëror më 25 prill të vitit 1929. Ai ishte dokumenti bazë i shërbimit diplomatik shqiptar, i cili nuk u zëvendësua nga një ligj tjetër i ngjashëm gjatë 70 viteve pasardhëse të veprimtarisë së MPJ. Ligji u botua në “Fletoren Zyrtare” më 8 maj 1929, Nr. 27.

Ligji përbëhet nga 8 kaptina (kapituj) dhe është mjaft kompleks për nga tërësia e komponentëve dhe problematikave që ai trajton, profesionalizmi që ai kërkon të ndërtojë në radhët e shërbimit të jashtëm, përcaktimi i qartë i detyrave, funksioneve dhe ndërtimi i përgjithshëm i këtij dikasteri. Të bie në sy centralizimi i kompetencave, për vetë natyrën e Monarkisë Konstitucionale shqiptare. Jo vetëm që ministri një herë në dy muaj paraqiste një raport Mbretit dhe qeverisë mbi aktivitetin dhe gjendjen e dikasterit që ai drejtonte, por edhe MPJ duhej të urdhëronte legatat shqiptare jashtë, që çdo raport me karakter politik që i dërgohej MPJ-së t’i dërgohej edhe qeverisë e Pallatit Mbretëror. Po këtë gjë duhej të bënte MPJ dhe për një kopje të notave me rëndësi që do të këmbenin me legatat e huaja në Tiranë. Ministri i Punëve të Jashtme kishte të drejtë të formulonte rregullore e qarkore të veçanta që rregullonin marrëdhënien ndërmjet zyrtarëve brenda në dikasterin e tij.

Kaptina e dytë trajtonte ndërtimin e administratës qendrore të MPJ-së, e cila do të përbëhej nga tre zyra kryesore, zyra e Sekretarit të Përgjithshëm, dhe dy drejtori: Drejtoria Politike dhe Drejtoria Administrative e Konsullore, që përfshinte edhe mbajtjen e kontabilitetit dhe menaxhimin e personelit të shërbimit të jashtëm. Stafi i drejtorive nuk përcaktohej vetëm me numrin e nëpunësve të nevojshëm, por

¹⁵ *Po aty*, V. 1928, D. 4, fl. 5, Korrespondencë e Oborrit Mbretëror me KM 15.12.1928, Qarkore e KM, 17.12.1928.

¹⁶ *Po aty*, V. 1928, D. 4, fl. 4, Korrespondencë e MPJ me KM, 15.12.1928.

përcaktohej edhe kualiteti diplomatik dhe rangu i ofiqit diplomatik i personave për të cilët ajo drejtori kishte nevojë. Ligji parashikonte që për nevoja specifike të shërbimit, mund të merreshin edhe zyrtarë nga jashtë e të paguheshin sipas pozicionit diplomatik që emëroheshin.

Në shërbimin diplomatik të shtetit shqiptar, Ligji Organik parashikonte këto pozicione diplomatike: Ministra Fuqiplotë të tre niveleve, Ministra Rezidentë (term që u hoq pas tre vitesh nga diplomacia, se përdorej rëndomë në shek. XIX)¹⁷, të Ngarkuar me Punë, sekretar legatë e konsullatë, atashe legatë, kryekonsuj, konsuj, nënkonsuj, konsuj karriere, konsuj nderi.

Drejtorët e zyrave nën kryesinë e Sekretarit të Përgjithshëm të MPJ-së formonin Këshillin e Ministrisë, i cili jepte mendim për emërimet, transferimet, gradime e pushimet e diplomatëve, për masat disiplinore që parashikonte ky ligj, e për probleme të tjera që u ngarkonte ministri.

Për efekt shpenzimi, disa legatë me afërsi gjeografike dhe veçori të përbashkëta politike, kishin vetëm një titullar, siç ndodhi me legatën e Parisit dhe atë të Londrës të cilat kishin vetëm një titullar i cili qëndronte një kohë të caktuar në Londër dhe një kohë tjetër në Paris. Gjerësia e juridiksionit tokësor të konsullatës e nënkonsullatës do të caktoheshin në dekretin e emërimit të titullarit. Me dekret mbretëror do të caktoheshin atributet konsullore sikundër të gjitha hollësitat që i takonin organizimit të përfaqësive.

Mjaft interesante paraqiten kriteret e rekrutimit të stafit të ri në shërbimin e jashtëm. Për t'u emëruar në MPJ, një kandidat duhet të plotësonte këto kushte:

1 - Me qenë nënshtrimit shqiptar e me gëzue të gjitha të drejtat politike e civile.

2 - Me pas krye shërbimin ushtarak ose me qenë i liruem prej këtij shërbimi.

3 - Mos me pas qenë dënue me burg për krime ose delikte dhe, kursesi për vjedhje, nënshtrim apo shpërdorim besimi apo faje të tjera që ndynjë nderin dhe tronditin besimin.

4 - Me njohë mirëfillti gjuhët shqip dhe frëngjisht.

¹⁷ Uran Asllani, *Diplomacia dhe diplomatët shqiptarë, 1912-1944*, Tiranë: "Ikar", 2006, f. 74.

5 - Nëpunësit e karrierës diplomatike nuk mund të martohen me gra prej race të huaj pa lejen e qeverisë. Ata që i kundërviheshin kësaj dispozite largoheshin nga detyra”.¹⁸

Mesa duket pika e fundit parashikonte që në MPJ të punonin vetëm meshkuj. *Në nenin 32 thuhet se daktilografiste mund të pranoheshin edhe femra.*

Për pozicionin Atashe, që ishte grada më e ulët, emëroheshin ata kandidatë që kishin një diplomë të Fakultetit të Drejtësisë, një shkollë të lartë të Shkencave Politike, apo një shkollë të lartë tregtie, pas një konkursi të organizuar nga Ministri i Punëve të Jashtme. Pas dy vitesh shërbimi në të dy drejtoritë, që konsiderohej si periudhë prove, nëpunësi Atashe gradohej si Sekretar i Tretë. Asnjë Atashe nuk mund të emërohej në legatë pa shërbyer të paktën një vit në qendër të Ministrisë së Punëve të Jashtme.

Kriteret e gradimeve ishin të përcaktuara qartë dhe preknin esencën e performancës jo vetëm të diplomatit, por edhe të personit si nëpunës i shtetit. Përveç vjetërsisë në gradën më të ulët, do të merreshin parasysht edhe vlerësimi dhe kujdesi i treguar në detyrë, morali dhe sjellja e mirë, vjetërsia në nënpunësi. Kalimi në një gradë diplomatike më të lartë bëhej vetëm kur ishte krijuar një vend bosh në hierarkinë e gradave të përcaktuara në numër. Ishin parashikuar edhe rastet kur diplomati duhej të gradohej edhe kur vendi vakant mungonte momentalisht.

Ligji njihte kategorinë e “nëpunësve në disponibilitet”, të njohur me vendim qeverie. Ky diplomat merrte një rrogë përse kohë ishte në këtë lloj “listë pritjeje” sipas ligjeve në fuqi të kohës, deri në hapjen e një vendi pune. Disponibiliteti nuk mund të zgjaste më shumë se 2 vite. Vetëm Ministrat Fuqiplotë mund të qëndronin në këtë pozicion deri në 3 vite. Parashikoheshin gjithashtu pagesat dhe të drejtat e diplomatëve sipas hierarkisë, po kështu edhe masat disiplinore ndaj tyre.

Miratimi i Ligjit Organik të Shërbimit të Jashtëm, dëshmonte se shteti shqiptar po hidhte hapa të rëndësishëm e të sigurtë për konsolidimin dhe forcimin e strukturave shtetërore.

Në qershor të vitit 1929, Oborri Mbretëror miratoi Rregulloren e Përgjithshme të Ceremonive zyrtare të shtetit shqiptar, ku përcaktoheshin edhe rregullat e paraqitjes së kredencialeve të përfaqësuesve të huaj tek Mbreti, por Drejtoria e Protokollit të Shtetit në atë periudhë nuk ishte

¹⁸ AMPJ, V. 1929, D. 12, f. 104-105, Ligji Organik MPJ.

pjesë e shërbimit të jashtëm, por e Oborrit Mbretëror.¹⁹ Megjithatë, sipas nenit 16 të saj, përfaqësuesi i huaj duhej të dorëzonte në MPJ kërkesën e tij për audiencë tek Mbreti dhe MPJ duhej të përcillte kërkesën për audiencë të përfaqësuesit të huaj tek Oborri Mbretëror.²⁰

Për shkak të mungesës se stafit të nevojshëm diplomatik për marrjen e pozicioneve me grada të larta diplomatike, Mbreti më 16.11.1929 dekretoi një ligj shtojcë ndaj Ligjit Organik të MPJ-së, ku lejohej që për pozicione me grada të larta të emëroheshin edhe nëpunësa me gradë më të ulët, e anasjelltas, që do të paguheshin me gradën e tyre plus një alokacion që do të caktonte KM, pas propozimit të MPJ duke mos e kaluar buxhetin e MPJ-së.²¹

Me propozim të MPJ, e pas miratimit në Parlament më dt. 11.4.1929, Mbreti dekretoi edhe Ligjin mbi Shërbimin Konsullor, më dt. 30 prill 1929, i cili plotësonte më mirë ligjin e parë përsa i përket përcaktimit të qartë të atributëve të shërbimit konsullor në mbrotje të interesave ekonomike të shtetit shqiptar dhe mbrojtjen e interesave të shqiptarëve jashtë atdheut. Ai synonte krijimin e një stafi të specializuar vetëm për shërbime konsullore.²²

Në përpjekje për të përfaqësuar në mënyrë sa më të paanshme interesat e shtetit, në kushtet kur shumica e diplomatëve vinin nga qëndrime të gjata jashtë për arsye shkollimi ose pune, në gusht 1929, MPJ inicioi projekt-dekretligjin "Mbi martesat e kontraktuara të nëpunësve të Ministrisë së Punëve të Jashtme". Në raportin justifikues të përgatitur nga Ministri i Punëve të Jashtme, Rauf Fico, theksohej se arsyet për këtë inicim ishin situatat e veçanta të personelit të MPJ-së dhe pasojat e dëmshme që mund të sillnin këto situata specifike. MPJ vendosi të merrte disa masa ndaluese dhe relativisht kufizuese në martesën e nëpunësve të saj. Në dekretligjin e iniciuar, nëpunësit aktivë të qendrës (MPJ) dhe ato të trupit diplomatik e konsullor jashtë vendit ndaloheshin të kontraktonin martesë me shtetase të huaja. Në nenin e dytë të tij parashikoheshin sanksione për nëpunësit që kryenin martesë të celebruara

¹⁹ AMPJ, V. 1929, D. 58, fl. 85, Korrespondencë e MPJ me legatat shqiptare, 21.9.1929; *po aty*, fl. 87, Rregullorja e Përgjithshme e Ceremonive, 26.9.1929.

²⁰ *Po aty*.

²¹ *Po aty*, V. 1929, D. 4, fl. 34, 14-Dekretligj i Zogut I mbi shtojcat në Ligjin Organik.

²² *Po aty*, V. 1929, D. 13, fl. 2-3, Raporti Justifikues i MPJ për Ligjin Konsullor, 28.1.1929; *po aty*, fl. 29-36, Ligji Konsullor.

me një shtetase të huaj në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji. Personit i hiqej e drejta e nëpunësisë që prej ditës së celebrimit të martesës e kjo situatë vazhdonte deri në zgjidhjen e kësaj martese. Për nëpunësin që aktualisht ishte i martuar me një zonjë nënshtetase e huaj, ndalohej të shërbente në shtetin, nënshtetësinë e të cilit kishte bashkëshortja e tij, ose të emërohej në atë shtet gjithë kohën që vazhdonte martesa e ndaluar. Nga ana tjetër, përsa i përket martesave të nëpunësve të MPJ me shtetase shqiptare, nëpunësit detyroheshin para se të kontraktinin martesën të merrnin autorizimin e MPJ-së. “Ky kufizim – thuhej në dekretligj - shihet i nevojshëm për arsye që kanë të bëjnë me prestigjin dhe me karakterin delikat që ka karriera diplomatike.”²³ Seksioni i Drejtësisë pranë Këshillit të Shtetit ku ky projektligj u dërgua për mendim, e modifikoi nenin e dytë të tij sipas të cilit “ndalimi vazhdon gjithë kohën e ekzistimit të shkakut ligjor ndalues”, duke e konsideruar një masë të rëndë fyese ndaj një nëpunësi. Në arsyetimin e tyre nuk kishte pse shteti të kërkonte zgjidhje të martesës, por largimin e diplomatit nga puna.²⁴ Projektligji bashkë me ndryshimet përkatëse iu kalua KM.

Organika e shërbimit të jashtëm shqiptar në maj 1929, na rezulton me 45 veta.²⁵ Ka shumë kërkesa nga të huajt (i parashikon ligji konsullor) për t’u emëruar konsuj nderi të Shqipërisë e për të mbuluar interesat tregtare e kulturore të saj jashtë vendit. Për shkak të fondit të kufizuar financiar i cili do të mundësonte ekzistencën e përfaqësive në shumë shtete ku Shqipëria kishte interesa, qeveria shqiptare për të pasur një përfaqësim të interesave kryesisht tregtare dhe të shtetasve shqiptarë jashtë, pranon shpesh kërkesa të nënshtetasve të huaj për konsuj nderi të Shqipërisë në shtetin e tyre, kryesisht njerëz me një gjendje të mirë financiare, dhe me një rreth të gjërë shoqëror. Para se të merrte vendim për pranim kandidature, MPJ merr më parë pëlqimin e legatave dhe të Bankës së Shtetit të vendit nga vinte kandidati për konsull nderi. Kjo e bënte më të sigurtë pritshmërinë e qeverisë shqiptare nga pranimi i kandidaturës së paraqitur.

Rauf Fico, Ministër i Punëve të Jashtme, diplomat mjaft i vlerësuar nga të huajt, këmbëngulte shumë në ngritjen e një shërbimi të

²³ *Po aty*, V. 1929, D. 39, fl. 2, Raporti Justifikues i MPJ për KM mbi projektligjin “Për Martesat”, gusht 1929.

²⁴ *Po aty*, fl. 6-7, Mendimi i Këshillit të Shtetit për projektligjin, 30.8.1929.

²⁵ *Po aty*, V. 1929, D. 21, fl. 6-7, Organika e MPJ, 24.4.1929.

përshtatshëm për kushtet ku kalonte Shqipëria dhe administrata e saj. Ai kurrë nuk ishte për zbatimin në Shqipëri të çdo norme që vinte nga Perëndimi, por që nuk përshtatej me realitetin shqiptar.

Kështu, më 3 shtator 1926, Kryetari i Republikës kishte aprovuar një Rregullore të propozuar nga ish-MPJ, Hysen Vrioni, mbi uniformën zyrtare të nëpunësve të trupit diplomatik dhe konsullor.²⁶ Kjo Rregullore u formulua pas propozimit të bërë në qeshor 1926 nga Ministri Fuqplotë në Paris, z. Iliaz Vrioni, për krijimin e një forme zyrtare për trupin diplomatik bashkë me katalogët e uniformave diplomatike të përdorura nga diplomatët perëndimorë.²⁷ Binin në sy qëndisjet me lule, e me fije ari, kapelet me kordele, ku spikatnin ngjyrat kombëtare, pelerinë e pendë, shpatë e formës franceze e varur në brez, doreza të bardha. Veshjet dallonin nga njëra - tjetra nga ofiqi zyrtar që do t'i mbante në shërbimin e jashtëm brenda e në legata. Ndërkohë më 29 prill 1929, Ministri i Punëve të Jashtme, Rauf Fico, i propozon Kryesisë së Këshillit të Ministrave që kjo Rregullore të anulohet "... për shkak të shumë të metave dhe inkonveniencën e saj".²⁸ Mbas vendimit të KM nr.319, dt. 11.05.1929, Mbreti Zogu I dekretoi më 3 qeshor 1929, anulimin e Rregullores së dt. 3.9.1926 duke mbështetur argumentimin e MPJ-së.²⁹

Në prill 1930, Rauf Fico inicion disa ndryshime në Ligjin Organik të MPJ. Kjo erdhi si efekt i nevojës për ndryshime që kishte konstatuar MPJ dhe ekzigjencave të rastit të ndeshura gjatë punës. Risia që sjell Fico është propozimi që bën ai për krijimin e një Përfaqësie Permanente pranë Lidhjes së Kombeve në Gjenevë. Fico argumentonte që "...në këtë mënyrë sigurohet një kontakt i përhershëm i Mbretërisë në qarqet ndërkombëtare-gjë që shfaqet si shumë e dëshirueshme për shkak të rëndësisë së madhe që kanë konferencat dhe mbledhjet ndërkombëtare në zhvillimin e politikës së jashtme. Mbretënia shqiptare tue mos pasë deri tash Përfaqësues Permanent, në mbledhjet e Shoqërisë së Kombeve ka dërguar delegatë të posaçëm dhe për këtë shkak janë shpenzuar shuma të mëdha për dieta dhe shpërblime udhëtimi. Por me gjithë këto shpenzime, Mbretëria e jonë nuk ka mundur të marrë pjesë në të tana mbledhjet e rëndësishme ndërkombëtare; kurse tash me krijimin e Përfaqësisë

²⁶ *Po aty*, V. 1926, D. 19, fl. 5-6, Rregullore mbi uniformën zyrtare të nëpunësve të trupit diplomatik e konsullor, 3.9.1926.

²⁷ *Po aty*, fl. 2, Korrespondencë e Legatës Paris me MPJ, 12.6.1926.

²⁸ *Po aty*, fl.17, Korrespondencë e MPJ me Kryesinë e KM, 29.4.1929.

²⁹ *Po aty*, fl. 19, Dekreti i Zogut I, 3.6.1929.

Permanente në Gjenevë me një shtesë të vogël në shpenzimet e shkaktume deri tashti, sigurohet ky kontakt dhe perceptim i nevojshëm”.³⁰

Ndryshim tjetër ishte suprimimi i disa konsullatave dhe kryekonsullatave të karrierës dhe zëvendësimin e tyre me Konsullata e Kryekonsullata Nderi. Kjo jo vetëm me qëllim të pakësimit të shpenzimeve, por edhe për të përfituar nga influencat dashamire dhe eksperiencat e mirënjohura të disa miqve të Shqipërisë të cilët nuk janë shtetas shqiptarë. Këto eksperiencia shpesh mungonin tek konsujt shqiptarë.³¹ Konkretisht propozoheshin të suprimoheshin Kryekonsullata e karrierës në Janinë, Konsullatat e karrierës në Boston, Stamboll e Vjenë e në vend të tyre të krijoheshin Kryekonsullate Nderi në Janinë dhe Vjenë, dhe Konsullatë Nderi në Boston e posti i Sekretarit të I-rë në Stamboll. Hapja e konsullatave të nderit dhe emërimi i titullarëve të perfaqësive bëhej me dekret mbretëror.

Ndryshimet e propozuara iu paraqitën Këshillit të Shtetit dhe KM në formën e shtojcës së Ligjit Organik. Kryesia e Këshillit të Shtetit u shpreh dakort për ndryshimet e propozuara.³² Kundërshtimi i vetëm ishte për mbylljen e Konsullatës së karrierës në Janinë dhe zëvendësimin e saj me një konsullatë nderi. Këshilli i Shtetit shfaqti mendimin që meqë Janina si një qytet afër kufirit shqiptar ishte edhe qendër me rëndësi për çdo aktivitet politik dhe tregtar të Greqisë, kishte një rëndësi të madhe për Shqipërinë si një post vëzhgimi për qeverinë shqiptare ndaj fqinjët të saj. Nga ana tjetër mungesa e një kolonie të fortë shqiptare në Janinë, nuk i jepte qeverisë shqiptare mundësinë t’i ngarkonte detyra patriotike një konsulli nderi, i cili do të ishte nënshkretas grek, dhe në mungesë të një kontrolli nga kolonia shqiptare ai mund të kryente aktivitete që nuk do të përputheshin me shërbimin e ngarkuar prej qeverisë shqiptare. Mbledhja e përgjithshme e Këshillit të Shtetit me shumicë votash vendosi që kryekonsullata e Janinës të mos suprimoheshin dhe justifikimi për kursim të shpenzimeve përkatëse nuk u pa i arsyeshëm.³³ Kolonitë shqiptare ishin aq aktive, sa shpesh ndodhte që autoriteti i legatës të konkurohej me fanatizëm nga kolonia shqiptare, që e konsideronte veten mbrojtëse të

³⁰ AMPJ, V. 1930, D. 3, fl. 33, Raport Justifikues i MPJ për projektligjin, 15.4.1930.

³¹ Po aty.

³² Po aty, fl. 32, Korrespondencë e KM me MPJ.

³³ Po aty, fl.34, Vendim i Këshillit të Shtetit nr. 229, prill 1930.

interesave të shqiptarëve, njohëse më e mirë e terrenit dhe e marrëdhënieve me shtetin shqiptar, siç ndodhte me koloninë shqiptare në Sofje.³⁴

Këto sugjerime iu komunikuan MPJ më 14 prill 1930, e cila bashkë me anekset e tjera ia dërgoi KM për mendim. Në këtë kohë për shkak të një incidenti diplomatik, më shumë të nxitur nga qeveria italiane, Rauf Fico kërkon dorëheqje tek Mbreti, edhe pse ajo nuk pranohet. Në këtë periudhë Fico nuk është aktiv në ndjekjen e projektit të tij.

Me mbërritjen e sugjerimeve në KM, Kryeministri dhe njëkohësisht zv.Ministri i Punëve të Jashtme Pandeli Evangjeli, kërkoj të reformonte krejt Ligjin Organik që të ofrohej me standartet e ligjeve analoge në monarkitë ballkanike e më gjerë.

Me anë të një Qarkoreje në nëntor të vitit 1930, KM i kërkoj të gjitha përfaqësive shqiptare jashtë që të siguronin modelet e ligjeve analoge, të rregulloreve për rekrutimin në shërbimin diplomatik e konsullor në shtetet ku ishin akredituar, dhe mbi bazën e tyre e të eksperiencës së tyre të jepnin mendimin e tyre personal si e mendonin ato, nevojën për ndërhyrje në Ligjin ekzistues Organik me synim përmirësimin e organizimit të MPJ dhe shërbimit diplomatik e konsullor jashtë vendit.³⁵

Gjatë nëntorit dhe dhjetorit 1930, filluan të vinin modele ligjesh të përkthyer në gjuhën shqipe nga stafet tona të përfaqësive, si dhe mendime nga të gjitha përfaqësitë, sesi e mendonin ata një organizim të ri të shërbimit të jashtëm, më funksional dhe efektiv në mbrojtje të interesave të shtetit dhe shtetasve shqiptarë. Propozimet që vinin ishin mjaft cilësore dhe shënonin një hap të ri në rrugëtimin e ndërtimit të shërbimit të jashtëm të shtetit shqiptar. Propozohej krijimi i Kabinetit të Ministrit, postit të Sekretarit të Përgjithshëm si pjesë e Kabinetit. Krijimi i Drejtorisë së Protokollit të Shtetit. Kësaj drejtorie t'i jepeshin edhe hartimet e ratifikimet e akteve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare, paraqitja e kredencialeve, pasaportat e vizat, madje edhe lidhja me Lidhjen e Kombeve në rast se nuk hapej një strukturë e veçantë për këtë. U propozua të hapej një seksion për shtypin, që të merrej me lajmet e shtypin e huaj e me propogandën në dobi të interesave të shtetit. Të hiqej

³⁴ *Po aty*, V. 1931, D. 3, fl. 275, Korrespondencë e Legatës Sofje me MPJ, 26.5.1931.

³⁵ *Po aty*, V. 1930, D. 3, fl. 60, Qarkore e MPJ për legatat shqiptare, 7.11.1930.

titulli “Ministër Resident” pasi shtetet e tjera kishin kohë që e kishin hequr. Në vend të saj të kishte Ministër Fuqiplotë të Klasit I dhe Ministër Fuqiplotë të Klasit II. Të bëhej qarkullimi i stafit qendër - përfaqësi në çdo tre vjet. Që të gjithë të përfitonin e të trajtoheshin për të shërbyer brenda e jashtë vendit. Në një marrëveshje midis Bankës Kombëtare dhe MPJ, të hapej një llogari për shefat e Misioneve të akredituara jashtë, që rrogat e alokacionet të mbërrinin në kohë në përfaqësi, gjë që sipas tyre lidhej me mbrojtjen e prestigjit të shtetit dhe dinjitetit të përfaqësuesve të tij.³⁶

Nga përfaqësitë diplomatike jashtë vendit kërkohesh që caktimi i alokacioneve të bëhej mbi bazën e rëndësisë së postit në ekuilibër me postet e tjera të asaj grade; koston e jetesës në shtetin ku përfaqësia ishte e akredituar, duke marrë parasysh raportin e monedhës vendase me arin, largësinë e postit nga qendra, ku personeli kishte nevojë të shkonte për arsye personale apo familjare dhe shpenzimet e udhëtimit përballoheshin nga vetë ato. Brenda postit të Ministrisë Fuqiplotë (ambasador) u propozua që të dalloheshin vendet me rëndësi prioritare për politikën e jashtme të shtetit shqiptar, dhe ato me rëndësi më të vogël, që për diplomatët do të thoshte më pak punë. “Po të merren parasysh këto konsiderata të sipërpërmendura-shprehet kryekonsulli ynë në Aleksandri - do të jetë me të vërtetë një lëvdatë për MPJ të Atdheut tonë, me që në këtë mënyrë do të shënjojë kuadrin e saj mbi baza të mbaruara nga tëra pikëpamjet në interes të Shqipërisë.”³⁷ U propozua që dy ligjet të shkriheshin në një të vetëm (ligji organik dhe ai konsullor), si dhe të bëhej një ndarje specifike e punëve në seksione brenda drejtorive sipas drejtimeve të përcaktuara të politikës së jashtme. Propozimet u depozituan në MPJ për t’u shqyrtuar.

Me Urdhër të Mbretit në janar 1932, edhe në MPJ u ngrit Shërbimi Kronologjik i regjistrimit të ngjarjeve më me rëndësi dhe aktiviteteve të zhvilluara nga fusha e politikës së jashtme. Regjistri do të mbahej nga atashe Thoma Kr. LUARASI, në varësi direkte të Sekretarit të Përgjithshëm.³⁸ Këto të dhëna do të shërbenin për të formuar bazën e burimit të historisë sonë kombëtare, sa më saktë dhe afër të vërtetës reale.

³⁶ *Po aty*, fl. 72-73, Korrespondencë e Legatës Sofje me MPJ e KM, 25.11.1930.

³⁷ *Po aty*, fl.78-80, Korrespondencë e Konsullatës së Përgjithshme Aleksandri me MPJ, 24.12.1930.

³⁸ *Po aty*, V. 1931, D. 3, fl. 29, Korrespondencë e MPJ me KM, 16.1.1932; *po aty*, fl. 663-664, Rregullore mbi regjistrimin e ngjarjeve me rëndësi, 15.1.1932.

Për këtë qeveria miratoi edhe rregulloren përkatëse “Mbi regjistrimin e ngjarjeve me Rëndësi”. Në fund të çdo viti këto regjistra do të raportoheshin në qeveri e të ruheshin në arkivën e saj.³⁹

III. Nevoja për konsolidimin e shërbimit të jashtëm dhe kriza ekonomike

Sfida e radhës në gjysmën e parë të viteve '30 do të ishte kriza financiare e kësaj periudhe ku Shqipëria nuk bënte përjashtim. Në zbatim të Urdhrit të Mbretit nr.339, dt.30.7.1931 ”Për formimin e një Komisioni të Posaçëm për kqyerjen e organizatës shtetërore”, në kuadrin e krizës financiare që kalonte Shqipëria dhe Evropa, në gjysmën e parë të viteve '30, u ngrit një komision i veçantë i cili filloi punën më 13 gusht 1931. Pasi mori në shqyrtim çdo zyrë, përpiloi edhe raportin përkatës i cili synonte të shkurtonte sa më shumë shpenzimet buxhetore. Ky ishte një kërcënim për kthim prapa në cilësinë e shërbimit të jashtëm shqiptar, i cili në fakt në natyrën e tij ishte një shërbim i kushtueshëm.

Për Ministrinë e Punëve të Jashtme raporti parashikonte: “Mbasi në këtë Ministri ka seksione të ndryshme që merren me atribucionet e kësaj Ministrije, dhe mbasi Ministri asht në kontakt direkt me drejtorët ose shefat e seksioneve, Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë, nuk i ngelet gjë tjetër, përveçse detyra e rregullimit të korrespondencës së përgjithshme të Ministrisë. Prandaj Komisioni në vend të Sekretarit të Përgjithshëm të kësaj Ministrie me gradën Ministër Fuqiplotë, e shef të mjaftueshme të ketë vetëm një Shef të Korrespondencës pa titull, i cili do të ketë nën drejtimin e nën survejimin e tij Protokollin, Arshivën e të tjera që kanë të bëjnë me detyrat e korrespondencës të Ministrisë. Shefi i Korrespondencës , do të bëjë edhe detyrën si shef i protokollit, d.m.th. i Ceremonialit Shtetëror”. Po kështu u propozua shkurtimi i stafit me një sekretar të II-të, me një sekretar të III-të dhe një atashe.

Përsa i përket legatave, në varësi edhe të ekzigjencave të politikës së jashtme shqiptare, për arsye ekonomike Komisioni propozonte: Parisi e Londra të hynin në juridiksionin e Romës. Në Paris e në Londër në rast nevoje të qëndronte një sekretar dhe Ministri i Romës detyrohej që dy-tre muaj në vit të shkonte në Paris e Londër. Në Uashington të suprimohej legata dhe të kishte vetëm një konsullatë të përgjithshme. Legata në Turqi të kishte në juridiksionin e saj edhe Bullgarinë dhe Rumaninë. Legata e

³⁹ *Po aty*, V. 1936, D. 9, fl. 26, Qarkore e KM për MPJ, 7.8.1936.

Romës të kishte në juridiksion edhe shtetet e tjera oksidentale. Legata e Beogradit të kishte në juridiksionin e saj edhe Çekosllovakinë e Hungarinë.⁴⁰ Ku kishte koloni shqiptare të kishte konsuj nderi ose konsuj karriere.

Ky raport iu paraqit KM bashkë me koston financiare që do të sillnin këto shkurtime, por ai u la pezull në kushtet e marrëdhënieve të acaruar politike me Italinë fashiste dhe pozitës delikate të shtetit shqiptar në zhvillimet rajonale e më gjërë të viteve '30.

Në zbatim të Ligjit Organik, pranimet e elementëve të rinj në MPJ filluan të bëhen me konkurs. Kryesisht bëhet fjalë për pranimet e atashëve. Konkursi zhvillohej në ambientet e Ministrisë, në formë orale dhe të shkruar. Ngarkohej Zyra e Shtypit të bënte njoftimin në të gjitha gazetatat e kryeqytetit për vendin vakant dhe për kriteret e përcaktuara më parë.

Lënda e përgatitjes:

- 1-E drejta ndërkombëtare publike
- 2-E drejta ndërkombëtare private
- 3-Historia diplomatike e Evropës (Historia e Traktateve)
- 4-Shqipëria dhe shtetet fqinje
- 5-E drejta shqiptare
- 6-Gjuha frënge- gramatikë, letërsi, bisedim e përkthim
- 7-Gjuha shqipe – Gramatikë, letërsi, përkthim.⁴¹

Gjuha franceze ishte kusht i domosdoshëm i mbarëvajtjes së punës në MPJ. Në qershor të vitit 1933, MPJ me anë të një qarkoreje drejtuar stafit të saj shtron domosdoshmërinë e mësimit të kësaj gjuhe si gjuhë pune e diplomatike. “Mbasi gjuha frënge është adoptuar përgjithësisht si gjuhë diplomatike, për nëpunësat e kësaj ministrie asht një nga cilësitë më të para që kërkohen prej tyne”. Për të gjithë diplomatët u vendos një afat kohor prej një viti për të mësuar gjuhën. “.. E në fund tue u bazue mbi këtë arsye, dhe me qëllim që të zhduket pengimi që mund të rrjedhë nga mos-dija e kësaj gjuhe, ftojme ato që nuk e dinë mirë që, brenda një viti të kujdesohen që ta perfeksionojnë atë. Në mbarim të këtij viti të

⁴⁰ *Po aty*, V. 1932, D. 5, fl. 16-19, Raport i Komisionit të Posaçëm për Kqyerjen e Organizatës Shtetërore, 4.3.1932.

⁴¹ *Po aty*, V. 1932, D. 8, fl. 197-203, Korrespondenca të MPJ me Zyrën e Shtypit në Ministrinë e Brendshme për njoftimet në gazeta lidhur me konkurset për pozicionin Atashe në MPJ, 11.1.1932.

caktuem do të bahen provimet dhe ay që nuk ka mujt ta përfeksionojë aq sa duhet për shërbimin zyrtar, do të gjejë pengim në karrierën e tij.⁴²

Në korrik 1932, në reformat që po merrte shteti shqiptar për forcimin e shkollës shqip, Ministria e Arsimit, nëpërmjet KM, i kërkon tërë dikastereve, që për nëpunësi të preferohen kandidatë që kanë mbaruar shkollën e mesme të vendit si Liceun e Korçës, Gjinnazin e Shkodrës apo të Tiranës, Shkollën Tregtare të Korçës ose Vlorës. “Meqenëse shkollat e huaja nuk kanë ndonjë specializim të veçantë, por thjesht shkolla të mesme, të preferohet arsimimi vendas. Kjo është një e drejtë e imponume prej interesit tonë kombëtar. Shkollat e huaja të pranohen vetëm nëse kandidojnë (paraqesin - P.D) specializim të veçantë.”⁴³

Vit pas viti shërbimi i jashtëm vazhdonte të plotësonte skeletin e tij me gjymtyrë të rëndësishme që mbështesnin përfaqësimin dhe mbrojtjen eficiente të interesave të shtetit të pavarur shqiptar.

Në janar të vitit 1932, me urdhër të Mbretit Zog I, KM i kërkon MPJ-së ngritjen e një biblioteke në atë Ministri ku të mbaheshin të gjitha, shtypshkrimet dhe çdo vepër që i përkiste Lidhjes së Kombeve. Këto libra nga KM do t'i kalonin MPJ-së. U dërguan 171 librat e parë, seri traktatesh, buletinesh, akte të konferencave ndërkombëtare etj.⁴⁴

Në vitin 1936, Dr. Fuat Asllani, Ministër i Punëve të Jashtme të asaj kohe, kërkon nga legatat tona kryesore, Londër, Paris, Romë e Athinë modelet e organizimit të arkivave historiko-diplomatike. Mbi bazën e tyre po në këtë vit kryhet një organizim krejt i ri, tematik e funksional i Arkivës së shërbimit të jashtëm shqiptar 1921-1936.⁴⁵

Ndërkohë vazhdonin shkurtimet financiare për buxhetin e MPJ-së e përfaqësive. Në vitin 1935, në zbatim të urdhrit të Mbretit Zog I, në MPJ u formua një Komision për shqyrtimin e organizimit të MPJ-së nën kryesinë e Ministrit të Punëve të Jashtme Z. Xhafer Vila. Ky Komision studioi imtësisht strukturën e MPJ-së (qendër + përfaqësi) duke e krahasuar edhe me strukturat e viteve të tjera, me qëllim gjetjen e mundësive të reduktimit më tepër të aparatit të MPJ-së për të kursyer

⁴² *Po aty*, V. 1933, D. 6, fl. 98, Qarkore e MPJ për legatat shqiptare, 14.6.1933.

⁴³ *Po aty*, V. 1932, D. 8, fl. 271, Korrespondencë e Ministrisë së Arsimit me KM, 12.1.1932.

⁴⁴ *Po aty*, V. 1932, D. 7, fl. 3, Korrespondencë e Zogut I me KM, 12.1.1932.

⁴⁵ *Po aty*, V. 1936, D. 281, fl. 7, Raport i MPJ për rishikimin e përgjithshëm të arshivës së MPJ, 3.8.1936.

buxhetin e dobët të shtetit. Buxheti i MPJ për vitin 1934-1935 ishte përgjysmuar në krahasim me vitin financiar 1933-1934. Komisioni arriti në konkluzionin se në qendër nuk mund të bëhej asnjë kursim edhe më i vogli. Personeli aktual nuk mund t'i bënte ballë punës që shtohet përditë, prandaj kërkohet shtesë personeli, të paktën të hapeshin dy pozicione një Atashe dhe një Daktilograf. Rrogat e tyre të dilnin nga kursimet e MPJ-së.

Pasi shqyrtoi gjendjen e konsullatave Komisioni vendosi si parim që ekzistenca e përfaqësive diplomatike e konsullore jashtë shtetit të mos cenohej dhe të mbeteshin siç janë mbasi formonin simbolin e pavarësisë kombëtare të shtetit shqiptar. U vendos gjithashtu që “..edhe konsullatat e suprimuara të mos zëvendësoheshin me konsuj nderi që ishin të huaj dhe merrnin 40% të të ardhurave të konsullatës, por të zëvendësosheshin me konsuj karriere të cilët jo vetëm do të ishin shtetas shqiptarë e do të dijnë të mbrojnë interesat e shqiptarëve në juridiksionin e tyre por edhe do të kishin mundësi të vinin në dijeni qeverinë për lëvizjet me karakter historik të këtyre qendrave me rëndësi”.⁴⁶

Po në vitin 1936, MPJ i propozoi Këshillit të Shtetit krijimin e një Legate Mbretërore në Bukuresht, nga suprimimi i postit të Sekretarit të Kryekonsullatës Mbretërore të Nderit në Bukuresht. Në raportin justifikues të saj thuhej se arsytet ishin: numri i madh i shqiptarëve që jetonin në Rumani, rëndësinë që përfaqësonte kolonia shqiptare atje, përmbushjen e nevojave të kësaj kolonie, si dhe një sjellje oborsie që të mbështeste marrëdhëniet shumë të mira midis dy Mbretërive. Ndërkohë që Rumania prej vitesh kishte përfaqësuesin e saj në Oborrin Mbretëror në Shqipëri.⁴⁷ Propozimi u gjet me vend nga Këshilli i Shtetit dhe qeveria dhe u dekretua nga Zogu I më 7 tetor 1936.

Po këtë vit u miratua edhe ngritja e Drejtorisë për Lidhjen e Kombeve dhe Minoritetet me një drejtor e dy diplomatë. Argumentimi i paraqitur ishte nevoja e krijimit të një zyre që merrej intensivisht me këtë organizëm të rëndësishëm ndërkombëtar, që të ndiqte më nga afër problemet për zhvillimin më të mirë të marrëdhënieve me të. Kjo drejtori do të ndiqte edhe punët që i përkisnin shqiptarëve jashtë kufijve të

⁴⁶ *Po aty*, V. 1935, D. 4, fl. 1-5, Raport i Komisionit të formuar në MPJ për shqyrtimin e situatës në shërbimin e jashtëm, 12.1.1935.

⁴⁷ *Po aty*, V. 1936, D. 7, fl. 22-23, Raport justifikues i MPJ për krijimin e Legatës mbretërore në Bukuresht, korrik 1936.

Shqipërisë dhe do të fillonte mbajtja e statistikave për numrin dhe gjendjen e tyre.⁴⁸

Në vitin 1936, Zyra e Shtypit nga Ministria e Brendshme iu kalua MPJ-së, me detyrën për të propoganduar imazhin e Shqipërisë jashtë vendit. Ajo do të bashkëpunonte ngushtë me legatat dhe konsullatat shqiptare jashtë për të përçuar saktë politikën e shtetit shqiptar.⁴⁹

Mbas ndryshimeve të kryera në vitin 1936 kemi këtë strukturë të shërbimit të jashtëm: Sekretari i Përgjithshëm, një Drejtori Politike me 7 diplomatë, Drejtorja e Protokollit të Shtetit me 2 diplomatë, Drejtorja e Lidhjes së Kombeve me 3 diplomatë, Drejtorja e Shtypit me 3 diplomatë, Zyra e Shifrave me 2 punonjës, Llogaria me dy punonjës, Arkiva me 2 punonjës dhe dy daktilografë. I gjithë shërbimi i jashtëm me gjithë stafin teknik kishte 64 veta, ndërsa lloji dhe rrjeti i përfaqësimit jashtë paraqitej si më poshtë:

Legata: Uashington, Londër, Berlin, Paris, Romë, Beograd, Athinë, Sofje, Kajro, Bukuresht.

Kryekonsullata: Aleksandri, Shkup, Stamboll, Selanik e Bari

Konsullatat: Manastir, Janinë, Korfuz, Vjenë, Boston, Gjenevë.⁵⁰

Në vitin 1936, u krijua edhe Kryekonsullata në Aleksandri, Selanik dhe Konsullata në Manastir dhe Janinë.⁵¹

Në mars 1937, MPJ pasi shqyrtoi propozimet e ardhura nga legatat shqiptare jashtë që në fillim të viteve '30 dhe mbështetur në problematikat dhe nevojat që kishte paraqitur ky shërbim pas miratimit të Ligjit Organik 1929, i paraqet KM Projekt-Ligjin e ri Organik të MPJ të përpunuar "...mbi bazën e nevojave të saj, të parimeve ndërkombëtare dhe të atyre që kanë adaptuar gjithë shtetet e qytetëruara" për t'ia kaluar Dhomës së Deputetëve për votim.⁵²

Ajo që vihet re në projekt ishte zgjerimi i kompetencave të Ministrit. "Ministri i Punëve të Jashtme kryeson dhe drejton shërbimet e dikasterit

⁴⁸ *Po aty*, fl. 40, Raport justifikues i MPJ mbi projektligjin për disa organizime të reja të punës në MPJ, nëntor 1936.

⁴⁹ *Po aty*, fl.8, Kupyre e fletore "Arberia", nr. 231, dt.10.4.1936.

⁵⁰ *Po aty*, V. 1936, d. 9, fl. 382, Struktura e organika e shërbimit të jashtëm, nëntor 1936.

⁵¹ *Po aty*, V. 1936, D. 7, fl. 2, Korrespondencë e MPJ me Këshillin Kontrollues, 18.3.1936.

⁵² *Po aty*, V. 1937, D. 2, fl. 8, Korrespondencë e MPJ me Kryesinë e KM mbi projekt-Ligjin Organik, 2.3.1937.

të tij. Nën urdhërin e kontrollin e tij kryhen këto detyra”, por zgjerohen edhe kompetencat e Sekretarit të Përgjithshëm, si kryediplomat, dhe ndërmjetës midis stafit të diplomatëve dhe Ministrisë.⁵³

KM ia dërgon projektligjin Këshillit të Shtetit, i cili në mbledhjen e tij të përgjithshme në prill 1937, dha mendim për materialin e paraqitur. Këshilli i Shtetit e quajti projektin e paraqitur një përsëritje e ligjit ekzistues të 8 majit 1929 në masën 95%. Pranon artikullin 1 për zgjerimin e detyrave të Ministrisë të Punëve të Jashtme, nuk pranon artikullin 3 për zgjerimin e strukturës së MPJ-së, madje kërkon shkurtrimin e saj për shkak të gjendjes financiare të shtetit. MPJ duhej të kishte vetëm dy zyra: Sekretaria e Përgjithshme dhe Drejtoria Administrative e Konsullore. Nga katër drejtoritë e propozuara kërkoheshin që detyrat e Drejtorisë Politike t’i kalonin Sekretarit të Përgjithshëm, detyrat e Drejtorisë së Lidhjes së Kombeve t’i kalonin Drejtorisë Administrative e Konsullore, Drejtoria e Shtypit t’i kalonte përsëri Ministrisë së Brendshme, dhe Drejtoria e Protokollit të Shtetit të suprimohej si e panevojshme. Krijoheshin vetëm Zyra e Ceremonive. Nga ana tjetër kërkoheshin të ngushtoheshin diferenca financiare e pozicioneve në MPJ me ato të dikastereve të tjera.⁵⁴ Në Këshillin e Shtetit pati edhe mendime kundër, si ai i Ajet Libohovës, por nuk përbënin shumicën. Sipas tij “Mekanizmi i administratës së brendshme ose të jashtme, nuk mund të paralizohet me qëllim kursimi, sepse, shtetet janë si një makinë orësh, e cila mund të jetë prej ari ose prej një metali me një vleftë të vogël. Por makina duhet të përmbajë në të dy rastet “aletet”(mjetet-P.D.) e njëllajtja”.⁵⁵ Këshilli i Shtetit përbëhej nga 7 anëtarë. Ranë dakort 6, kundër 1. Më 1937 shërbimi i jashtëm kishte punësuar gjithsej 67 persona.⁵⁶

Për të përballuar nevojat e MPJ-së Mbreti miratoi shtesë fondesh, të marra nga fondi rezervë (shpenzime të fshehta), i cili do të plotësohej me

⁵³ *Po aty*, fl. 9, Projektligji Organik i propozuar.

⁵⁴ *Po aty*, fl. 29-35, Vendim nr.134 i Këshillit të Shtetit për projektligjin Organik të paraqitur, 9.4.1937.

⁵⁵ *Po aty*, fl. 32-35.

⁵⁶ *Po aty*, V. 1938, D. 160, fl. 34-36, Shpenzimet financiare të përfaqësive për ushtrimin financiar 1937/1938 e Qarkore e MPJ për këtë problem, gusht 1938.

shkurtim të rrogave të personelit dhe shkurtim të shpenzimeve të ndryshme për përfaqësitë.⁵⁷

Në fillim të vitit 1939, MPJ pezullon të gjitha emërimet e reja në MPJ, sepse nuk kishte vende vakante për emërimet as në MPJ as synohej të hapeshin konsullata të tjera nderi, edhe pse kishte kërkesa.⁵⁸ Sherbimi i jashtëm në këtë vit numëronte 81 veta.⁵⁹ Në mars 1939 krijohet Legata Mbretërore në Budapest, por mbulohet nga Ministri Fuqplotë Rauf Fico në Berlin.⁶⁰ Në raportin justifikues thuhej se krijimi kesaj legate kishte vetëm kuptim teorik, sepse legata do ta kishte qendrën në Berlin. Nga ana tjetër Hungaria e mbulonte Shqipërinë nga Roma.⁶¹

Përpjekia e fundit për të plotësuar skeletin e shërbimit të jashtëm shqiptar para pushtimit të Shqipërisë kryhet nga Ministri Ekrem Libohova, i cili i kërkon legatave në Athinë e Beograd, se cili është statusi i Nënministrit në vendet ku ishin akredituar dhe cilat ishin relatat me Ministrat. A kishin kompetenca të ndara përsa i përket nënshkrimit të akteve me rëndësi të posaçme.⁶² Përgjigja nga Athina bënte të qartë se posti i Nënministrit bënte pjesë në Kabinetin qeveritar vetëm për disa ministri të rëndësishme. Ai emërohej bashkë me ministrat në Kabinet. Kishte hyrje të lirë në Parlament, por votonte vetëm nëse ishte deputet. Merrte të njëjtën pagë me Ministrin, merrte pjesë në mbledhje të KM dhe ushtronte të gjitha detyrat e Ministrisë, përveç atyre që Ministri i mbante për vete.⁶³ Në Jugosllavi kjo praktikë nuk ekzistonte.⁶⁴ Eqrem Libohova njoftonte KM përsa më sipër.

Ky pozicion zyrtar, i ngjashëm me postin e Sekretarit të Shtetit, nuk arriti të aplikohet në Kabinetin qeveritar, për shkak të pushtimit italian të

⁵⁷ *Po aty*, fl.52, Dekretligji mbi bartje fondesh të MPJ në ushtrimin financiar 1938/1939.

⁵⁸ *Po aty*, V. 1939, D. 11, fl. 19.30, Korrespondencë e MPJ me aplikantë për punën në MPJ, janar 1939, dhe me legatat shqiptare, janar 1939.

⁵⁹ *Po aty*, fl. 32, Kuadri numerik i MPJ. Ushtrimi financiar 1938/1939.

⁶⁰ *Po aty*, fl. 38, Dekreti i Zogut I për krijimin e Legatës Mbretërore në Budapest, 27.3.1939.

⁶¹ *Po aty*, fl. 36, Raporti justifikues i MPJ për krijimin e Legatës Mbretërore në Budapest, janar 1939.

⁶² *Po aty*, fl. 117, Korrespondencë e MPJ me legatat në Athinë dhe Beograd, 14.3.1939.

⁶³ *Po aty*, fl. 121, Përgjigje e Legatës Mbretërore Athinë, 21.3.1939.

⁶⁴ *Po aty*, fl. 122, Përgjigje e Legatës Mbretërore Beograd, 24.3.1939.

vendit. Por kjo eksperiencë do të shfrytëzohej në qeverinë e parë pas kapitullimit të Italisë fashiste, e drejtuar nga Rexhep Mitrovica në nëntor 1943.

Pas pushtimit të Shqipërisë më 7 prill 1939, u krye bashkimi personal i dy Mbretërive. E para që suprimohet në maj 1939 ishte Legata shqiptare në Romë.⁶⁵ Nga dy Ministrat e Punëve të Jashtme, Dino dhe Ciano, më 3 qershor 1939, nënshkruhet një Akord në bazë të të cilit shërbimet diplomatike e konsullore të të dy vendeve u unifikuan dhe drejtimi i të gjitha marrëdhënieve ndërkombëtare të Italisë dhe të Shqipërisë u përqendrua në MPJ në Romë. Përfaqësimi i shtetit shqiptar vazhdoi vetëm në tre shtete që nuk e njohën pushtimin, Republika Turke, Republika Franceze dhe Mbretëria e Egjiptit.⁶⁶

Shumë nga diplomatët shqiptarë nuk pranuan të shërbejnë për MPJ italiane dhe dolën të papunë ose në pension. Një pjesë u angazhuan tek Zyra e Likuidimitit për të mbyllur çështjet administrative të mbetura hapur nga MPJ Shqiptare, por vetëm një pjesë e vogël e tyre pranonte porosinë e dhëna nga autoritetet italiane.

Ky shërbim krijoi një bazë të rëndësishme eksperience pozitive, për të ndërtuar një shërbim të jashtëm të një shteti të pavarur, eksperiencë që do të përdorej nga regjimet e qeveritë pasardhëse, të cilat nuk do ta nisnin jetën e tyre në një hapësirë boshe.

S u m m a r y

THE ALBANIAN FOREIGN SERVICE DURING THE YEARS OF MONARCHY (1928-1939)

After the establishment of the monarchy, on 1st September 1928, and in a situation of political stability at home, the process of the consolidation of the Albanian foreign affairs service and its legal framework went through a faster pace development. This important process for the recognition of an independent

⁶⁵ *Po aty*, V. 1939, D. 16, fl. 3, Korrespondencë e MPJ me Të Ngarkuarin me Punë në Romë, Assaf Libohova, maj 1939.

⁶⁶ U. Asllani, *Diplomacia dhe diplomatët ...*, f. 117.

and sovereign state faced great challenges during the late 1920's and 30's as the international interests did not favor Albania. Some of these challenges and difficulties that need to be pointed out were: the confusion created by the clash of models inherited by an oriental past and the goals to achieve western liberal democracies standards, the lack of a previous foreign service, a lack of qualified staff, the economic crisis of 1930's while the foreign affairs service was a costly one, the Italian pressure on Albanian foreign policy, etc. However, addressing these challenges and implementing the western models was the key to establishing a dignifying foreign service with a well educated diplomatic staff who was committed to become professional. In addition, it was designed the necessary legal framework which clearly defined the diplomatic ranks, duties, competencies and rights of this service's officials. The number of Albanian embassies increased and considering the economic crisis there were defined the possible mechanisms to overcome financial obstacles which would allow the representation of the Albanian citizens and their interests in a wider geographic area. This was a very beneficial period with regard to the Albanian foreign service and an experience which could be used by future governments and which had been lacking in the past.